Financuar nga Bashkimi Europian.

Hedayah
countering violent extremism

Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

BASELINE STUDY

Mbulimi dhe raportimi mediatik i ekstremizmit e dhunshëm dhe terrorizmit

Vlerësimi i nevojave të gazetarëve, studentëve të gazetarisë dhe zëdhënësve të institucioneve publike

Ky studim u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, në kuadrin e një projekti të menaxhuar nga Qendra Ndërkombëtare për Ekselencë në Luftën ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm HEDAYAH. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Europian.

INSTITUTI SHQIPTAR I MEDIAS

BASELINE STUDY

Mbulimi dhe raportimi mediatik i ekstremizmit e dhunshëm dhe terrorizmit

Vlerësimi i nevojave të gazetarëve, studentëve të gazetarisë dhe zëdhënësve të institucioneve publike

Tiranë, Shkurt 2020

Dr. Erlis Çela

PËRMBAJTJA

Hyrje 5
Konteksti i përgjithshëm 6
Metodologjia 8
Analiza e të dhënave 9
Gazetarët 10
Raporti me burimet e informacionit 13
Shqetësimet në lidhje me raportimin e ekstremizmit 14
Studentët e gazetarisë 16
Mbulimi i ekstremizmit dhe radikalizmit si pjesë e kurrikulës universitare 16
Shkalla e njohurisë te studentët 17
Gjuha e urrejtjes 19
Shoqëria civile 19
Nevojat për trajnim sipas këndvështrimit të shoqërisë civile 21
Bashkëpunimi i shoqërisë civile me aktorë të tjerë 22
Pengesat sipas shoqërisë civile 23
Zëdhënësit e institucioneve shtetërore 23
Rritja e aftësive profesionale 25
Përfundime 26
Bibliografia 29

LISTA E FIGURAVE

Figurë 1-Interesi i Pjesëmarrjes në Trajnim 9
Figurë 2 - Nevoja për trajnim..... 10
Figurë 3-Aftësia për të raportuar..... 11
Figurë 4-Pjesëmarrja e mëparshme në trajnim 11
Figurë 5-Udhëzimet lehtësojnë raportimin 12
Figurë 6-Burimi kryesor i informacionit 13
Figure 7-Vlerësimi për bashkëpunimin 14
Figurë 8-Transparenca e institucioneve shtetërore..... 15
Figurë 9-Niveli i njohurisë mbi lajmet e rreme dhe dezinformimin..... 16
Figurë 10-Përfshirja në kurrikul 17
Figurë 11-Shkalla e njohurisë te Studentët..... 178
Figurë 12-Fushat që duhen përmirësuar 18
Figurë 13-Gjuha e urrejtjes 19
Figurë 14-Hartimi i Udhëzimeve 20
Figurë 15-Shkalla e njohurisë së shoqërisë civile mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin..... 21
Figurë 16-Nevoja për trajnim 22
Figurë 17-Bashkëpunimi me Median 22
Figurë 18-Mungesa e njohjes së terminologjisë sipas Shoqërisë Civile..... 23
Figurë 19-Bashkëpunimi i Zëdhënësve me Media online 24
Figurë 20-Mungesa e aftësive për të raportuar mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin..... 25
Figurë 21-Interesi per trajnim 26

LISTA E TABELAVE

Table 1-Shqetësimet në lidhje me raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. 15

HYRJE

Diskutimet mbi mënyrën sesi media mbulon ngjarje të aktualitetit, situata të ndryshme, problematika dhe fenomene të shoqërisë, përbëjnë një nga fushat më të gjera të studimeve mbi efektet e mediave. Në përgjithësi, debate mbi efektin që ka raportimi mediatik i ngjarjeve të ndryshme në opinion publik, lidhet ngushtë me idenë se media ka fuqinë të ndikojë opinionin, të orientojë sjelljet dhe qëndrimet e publikut. Megjithatë ky diskutim, nuk ka të bëjë vetëm me studimet me fokus standardet profesionale dhe etike të gazetarëve, apo me faktorët që ndikojnë politikat editorale të medias. Fokusimi në hulumtimin e efekteve të medias përfshin një sërë disiplinash dhe përpiqet të hedhë dritë mbi rolin e mediave tek individi dhe shoqëria.

Media, sipas paradigmës së njohur të ndarjes së pushteteve, konsiderohet si pushtet i katërt që ka si detyrë të mbikqyrë aktivitetin e tre pushteteve të të tjera, në interes të publikut. Mbulimi mediatik i ngjarjeve përfshin edhe aktorë të tjerë jashtë medias, të cilët bashkëpunojnë me gazetarët, qoftë si burim parësor i informacionit, qoftë edhe si kontributorë direkt në procesin e prodhimit të lajmit. Në këtë këndvështim, është e nevojshme që gjatë studimeve mbi mbulimin mediatik, të adoptohet një qasje multi-faktoriale, multidisiplinoare, e cila krahas gazetarëve përfshin edhe aktorë të tjerë si institucionet publike, shoqërine civile, etj.

Raportimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, përbën një nga sfidat e medias sot në mbarë botën. Që pas sulmit mbi kullat binjake në 11 shtator 2001, deri në ditët e sotme, gazetarët në mbarë botën kanë raportuar mbi aktet terroriste, luftra dhe akte dhune, duke u përballur me sfida profesionale dhe etike. Manualet dhe udhëzimet e hartuara për të orientuar reporterët në mbulimin e këtyre ngjarjve, këshillojnë gazetarët që të raportojnë bazuar në fakte dhe të kontekstualizojnë raportimet e tyre. Në pamje të parë duket se respektimi i parimeve bazë deontologjike dhe etike, është i mjaftueshëm edhe në mbulimin e këtyre ngjarjeve. Pra gazetarët ashtu si në situata të tjera, edhe gjatë mbulimit të ekstremizmit të dhunshëm apo terrorizmit, duhet të sigurojnë që raportimi të jetë objektiv, i saktë, i paanshëm, gjithëpërfshirës, dhe i bazuar në fakte.

Megjithatë në praktikë vihet re se shpesh këto norma janë të interpretueshme, varësisht kontekstit social-politik, formimit të gazetarëve, kulturës gazetareske dhe marrëdhënieve të medias me aktorë të tjerë shoqërorë. Këto dilema shoqërojnë prej vitesh edhe median në shqiptare. Mbulimi i ngjarjeve terroriste të 11 shtatorit ishte përballja e parë shumë gazetarëve shqiptare me këtë kategori informacionesh. Raportimi mbi masat që mori Shqipëria për të kontrolluar dhe më pas mbyllur një sërë organizatash të dyshuara në lidhje me Al Qaeda-n, e bënë më të prekshme sfidën për reporteret dhe median shqiptare.

Në vitet në vijim, media shqiptare i ka mbuluar ngjarjet terroriste në gjithë botën bazuar në qasjen e mediave të mëdha perëndimore. Kjo ka bërë që informacionet lidhur me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar, t'i përcillen audiencës shqiptare si zhvillime larg realitetit vendas. Për rrjedhojë mediat kryesore në vend, i kanë kushtuar shumë pak

vëmendjen përgatitjes së gazetarëve dhe profesionistëve të fushës për mbulimin e këtyre ngjarjeve. Të fokusuar më shumë te sensacionalizimi për efekt të gjenerimit të audiencës, dhe të ndikuar nga kornizimi që media botërore i bën terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, media shqiptare ka bërë shumë pak në drejtim të kontekstualizimit të raportimit mbi këto fenomene.

Media shqiptare filloi të mbulojë më intensivisht këto fenomene, me fillimin e konfliktit në Siri dhe shfaqjes në publik së organizatës ISIS. Përfshirja e individëve nga Shqipëria dhe Kosova në këtë konflikt përbën ende një nga tematikat kryesore të raportimit mbi ekstremizmin dhe radikalizmin. Gazetarët shqiptarë sot e kanë të nevojshme të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth terminologjisë së fushës, terminologjisë fetare, si dhe të respektojnë normave deontologjike dhe profesionale.

Rritja e shkallës së njohurive duhet të fillojë më studentët e gazetarisë, përmes përfshirjes së këtyre tematikave në kurrikulat e programeve të gazetarisë. Për profesionistët e fushës, të cilët mbulojnë ngjarje që lidhen me terrorizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm është e nevojshme përfshirja në trajnime dhe forma të tjera të edukimit profesional, në mënyrë që të rriten kapacitetet dhe aftësitë profesionale.

KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM

Ekstremizmi i dhunshëm dhe rreziku i terrorizmit mbeten të pranishme në realitetin shqiptar. Ndërgjegjësimi për fenomenin dhe përmirësimi i kuadrit ligjor kanë përparuar vitet e fundit duke bërë që tematikat dhe diskutimet rreth çështjeve të tilla të jenë më prezente në hapësirën mediatike dhe sferën publike. Aktorë të ndryshëm, përfshi këtu shoqërinë civile, median, institucionet shtetërore të sigurisë, komunitetet fetare, etj, gjithnjë e më shumë po kuptojnë se këto fenomene kërkojnë një koordinim mjaft të mirë në mënyrë që të adresohen siç duhet. Studimet e fundit të fokusuar në vlerësimin e riskut dhe evidentimin e faktorëve nxitës të ekstremizmit të dhunshëm, e konfirmojnë praninë e fenomenit në shoqërinë shqiptare. Konflikti në Siri dhe përfshirja e individëve nga Shqipëria dhe rajoni i Ballkanit, tregojnë se faktorët nxitës të ekstremizmit ekzistojnë në shoqërinë tonë.

Ekstremizmi i dhunshëm me bazë fetare përbën epiqëndrën e vëmendjes institucioneve shtetëore dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në parandimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Për rrjedhojë mund të themi se është nënvlerësuar mundësia për format e tjera të ekstremizmit. Një studim i fundit i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, vlerëson "se aktorët shqiptarë e kanë nënvlerësuar potencialin e ekstremizmit jofetar. Një potencial i tillë shfaqet tek një numër i konsiderueshëm shqiptarësh që justifikojnë përdorimin e mjeteve të paligjshme për përballimin e problemeve, përfshirë këtu luftën e përditshme për mbijetesë, sistemin politik që perceptohet si i pandershëm apo që i shërben vetëm elitave me lidhje të forta, dhe mohimin e të drejtave dhe lirive nga institucionet shtetërore" (Vurmo & Sulstarova, 2018).

Ky studim evidentoi një sërë nxitësish të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ndër më kryesorët janë nxitësit social-kulturorë që lidhen më së shumti me gjendjen e komuniteteve në periferi të zonave urbane, si dhe nxitësit politikë që përfshijnë korrupsionin dhe pandëshkueshmërinë e shkelësve të ligjit.

Një nga shqetësimet kryesore në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin ka të bëjë me potencialin që mbart për të krijuar terren për lindjen e konflikteve me bazë fetare, çka do të cënonte një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë: harmoninë dhe bashkëjetesën fetare. (Zguri, 2017)

Në këtë kontekst, mbulimi mediatik i ekstremizmit të dhunshëm merr një rëndësi të veçantë. Respektimi i etikës gazetareske dhe informimi i publikut në mënyrë profesionale mbi ngjarjet e ekstremizmit të dhunshëm, është me rëndësi të veçantë për shoqërinë shqiptare.

Studime të mëparshme kanë theksuar rëndësinë që ka rritja e njohurive fetare dhe profesionalizmit të gazetarëve që mbulojnë ngjarje të ekstremizmit fetar. Ndonëse jo në nivel shqetësues në disa raste, media i krijon hapësirë një diskursi që lidhet me islamofobinë. Studiuesi Rrapo Zguri thekson se është shqetësuese përdorimi i Islamofobisë si pjesë e ligjërimit ekstremist islamist dhe si alibi për të maskuar apo për të mbështetur propogandën dhe veprimtarinë ekstremiste (Zguri, 2017).

Një studim i kryer nga "American Friends Service Committee (AFSC)" mbi mënyrën sesi media amerikane mbulon ekstremizmin e dhunshëm, ve në dukje fuqinë kornizuese që ka media për ngjarjet që pasqyron. Në studim një nga pyetjet kryesore që kërkon përgjigje është "Çfarë tjetër mbulon media kur raporton mbi ekstremizmin?" (Hallowell, 2016)[1].

Në manualin e UNESCO mbi terrorizmin dhe median, vihet theksi te faktorët që ndikojnë në cilësinë e mbulimin të terrorizmit nga media. Cilësia e mbulimit dhe raportimit mediatik mbi terrorizmin lidhet me shkallën e lirisë së medias, burimet ekonomike në dispozicion të medias, faktorët kulturorë, konceptimi i normave etike dhe rolin social të mediave (Marthoz, 2017).

Në kontekstin shqiptar është e rëndësishme që paralelisht me faktorët që ndikojnë në cilësinë e mbulimit, të kuptojnë shqetësimet dhe nevojat e medias dhe grupeve të tjera të përfshira në informimin e publikut mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Për gazetarin dhe ekspertin e medias Lutfi Dervishi është shqetësuese mungesa e reporterëve të specializuar për mbulimin me profesionalizëm çështjet fetare. (Dervishi, 2018). Në kushtet e një krize të vazhdueshme nëpër të cilën kalon media shqiptare, duket sikur kërkesa parashtrimi i idesë së gazetarëve të specializuar për raportimin e ngjarjeve fetare, nuk është prioritet i medias. Megjithatë duhet kuptuar se mbulimi me profesionalizëm i aktiviteteve dhe zhvillimeve fetare në

[1] Hallowell, B. (2016). MIXED MESSAGES, How the media covers "violent extremism" and what you can do about it. American Friends Service Committee.
https://www.afsc.org/sites/default/files/documents/Mixed%20Messages_WEB.pdf

vend, i shërben ruajtjes dhe promovimit të harmonisë dhe bashkëjetesës në shoqërinë multifetare shqiptare.

METODOLOGJIA

Studimi synon të identifikojë dhe matë nevojat e gazetarëve, studentëve të gazetarisë dhe përfaqësuesve të institucioneve publike për t'u përballuar me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ky studim ofron një panoramë të plotë të njohurive, përceptimeve dhe nevojave të gjithë aktorëve të lartpërmendur në raport me çështjet që lidhen me ektremizmin e dhunshëm, terrorizmin dhe radikalizmin.

Studimi është mbështetur në një metodologji të kombinuar, ku janë përdorur si metodat sasiore ashtu edhe ato cilësore. Në kuadër të metodave sasiore, u realizua *anketimi* i 112 individëve. Kampionimi mori parasysh përfaqësimin e të katër grupeve të lartpërmendura duke përfshirë pyetje të përgjithshme dhe pyetje të veçanta për të identifikuar nevojat specifike të secilit grup.

Pyetësori për gazetarët dhe redaktorët, përbëhej nga 21 pyetje, nga të cilat 15 ishin të orientuara për të identifikuar njohuritë rreth ekstremizmit të dhunshëm, nevojat e gazetarëve dhe drejtuesve të redaksive në lidhje me përmirësimin e mbulimin dhe raportimin e ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe radikalizmit. Ky grup pyetjesh synonte gjithashtu të grumbullonte të dhëna për vlerësimin e elementëve që pengojnë raportimin cilësor, si dhe perceptimin gazetarëve mbi besueshmërinë e burimeve të informacionit.

Gjatë hartimit të kampionit të **gazetarëve dhe redaktorëve** të përfshirë në këtë sondazh, është treguar kujdes që ai të jetë sa më përfaqësues. Për rrjedhojë kampioni, paraqet një ndarje të balancuar të personave që punojnë në median tradicionale (tv, radio, gazeta) dhe atyre që janë të angazhuar në median online. Krahas përfaqësimit të strukturës së tregut të mediave në vend, grupi prej 46 gazetarësh dhe redaktorësh, është përfaqësues edhe përsa i përket eksperiencës në punë, moshës, gjinisë dhe nivelit arsimor.

Grupi i dytë i përfshirë në sondazh ishin personat e angazhuar si z**ëdhënës** për media apo profesionistë të komunikimit me publikun në institucione të ndryshme shtetërore. Pyetësori i përgatitur për këtë grup, krahas pyetjeve të përbashkëta për vlerësimin e njohurive mbi terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, synon të masë perceptimin mbi rolin e medias, shkallën e bashkëpunimit si dhe nevojën për hartimin e udhëzimeve përkatëse. Ky kampion përbëhej nga 16 individë, të angazhuar në ministri, bashki dhe institucione të tjera publike.

Pyetesori i tretë iu drejtua 20 **studentëve të gazetarisë**. Ky grup përfshinte studentë të gazetarisë dhe komunikimit në 3 nga 4 universitet e vendit që ofrojnë këto programe. Pyetësori për studentët, përfshin pyetje që synojnë të zbulojnë shkallën e trajtimit të çështjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, terrorizmin dhe dezinformimin në kurrikulat e këtyre programeve.

Një nga aktorët më të rëndësishëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, është **shoqëria civile.** Një pyetësor i veçantë u hartua për të vlerësuar perceptimin e 30 përfaqësuesve të shoqërisë civile, pedagogëve të universitetit dhe studiuesve të pavaruar mbi rolin e medias dhe institucioneve publike në luftën kundër ekstremizmit dhe radikalizmit. Në këtë rast kampionimi synon të përfshijë në mënyrë të veçantë përfaqësues të organizatave të cilat kanë qenë të angazhuara në projekte të mëparshme në këtë fushë.

Komponenti i dytë i metodologjisë ka të bëjë me katër *intervistat e thelluara,* me aktorë përfaqësues të shoqërisë civile, medias, komuniteteve fetare dhe institucioneve shtetërore. Arsyeja kryesore e përfshirjes së komuniteteve fetare ne grupin e intervistave, qëndron në faktin se anketa e realizuar me gazetarët kërkonte të vlerësonte perceptimin mbi bashkëpunimin me median në rast të raportimit të ekstremizmit me bazë fetare. Intervistat e thelluara në këtë rast janë përdorur si një instrument i përqasjes kualitative që synon të pasurojë të dhënat sasisore me këndvështrime më të detajuara dhe të ndihmojë për të shpjeguar arsyet e rezultateve empirike.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e pyetësorëve të realizuar me gazetarët, studentët e gazetarisë, shoqërinë civile dhe zëdhënësit e institucioneve publike na japin një panorame të qartë të njohurive, perceptimeve dhe nevojave që ka secili nga këta aktorë në ngritjen dhe forcimin e kapaciteve për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin në Shqipëri. Për të patur një panoramë më të qartë për secilin nga grupet e përfshira në studim, analizimi i të dhënave është bërë i veçuar.

Rezultate të përbashkëta

Të dhënat e pyetjeve të përbashkëta për të katër grupet, nxjerrin në pah nevojën në dukje për të rritur njohuritë në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin nëpërmjet trajnimeve dhe formave të ngjashme të edukimit. Siç mund të vihet re në grafik, interesi i gazetarëve për marrë pjesë në trajnime për raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit është mjaft i lartë. Më konkretisht



Figurë 1-Interesi i Pjesëmarrjes në Trajnim

50% e të anketuarve janë shprehur se janë "jashtëzakonisht" të interesuar për të marrë pjesë në trajnim, ndërkohë që se bashku me 26% të atyre që janë shumë të interesuar, shkalla e interesit për të rritur njohuritë e raportimit nëpërmjet trajnimeve shkon në 76%. Në rastin e studentëve të gazetarisë, interesi për të marrë pjesë në trajnime shfaqet në nivel disi më lartë se në dy grupet e tjera. Të pyetur sa të interesuar do të ishin për të marrë pjesë në trajnime 60% e tyre janë shprehur shumë të interesuar, ndërsa 25% "jashtëzakonisht i interesuar". Ndërkohë që edhe në rastin e zëdhënësve të institucioneve publike, interesi për të rritur njohuritë dhe kapacitetet mbi këto tema, rezulton të jetë shumë i lartë. Të dhënat e paraqitur në grafikun e mësipërm, na japin një panoramë të qartë të nevojës për trajnimin zëdhënësve, studentëve dhe gazetarëve të përfshirë në mbulimin dhe raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Një e dhënë tjetër e rëndësishme që mbështet nevojën për trajnim është edhe perceptimi i përfaqësuesve të shoqërisë civile. Të pyeturve nga ky grup u është kërkuar të shprehin mendimin e tyre për nevojat e trajnimit të gazetarëve, zëdhënësve dhe përfaqësuesve të instutucioneve publike. Siç mund të vihet re dhe nga grafiku, 73% e të anketuarve janë plotësisht dakord me qëndrimin se ka shumë nevojë për trajnim.



Figurë 2-Nevoja për trajnim

Gazetarët

Raportimi mbi terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, veçanërisht ai mbi baza fetare, ve në provë shpesh kapacitet dhe aftësitë profesionale të gazetarëve shqiptarë. Në përgjithësi raportimi mbi fenë në median shqiptare, në këto vite ka qenë mjaft sipërfaqësor dhe në shumicën e rasteve, gazetarët reflektojnë një mungesë të theksuar të njohurive mbi terminologjinë fetare apo domethënien e riteve të ndryshme.

Studime të mëparshme kanë nxjerë në pah format kryesore të raportimeve mbi fenë në median shqiptare. Krahas mbulimit të festave, dhe ngjarjeve brenda komuniteteve, media raporton mbi fenë edhe në rastet e konflikteve apo individëve të radikalizuar që janë bërë pjesë e konfliktit sirian. Studiuesit kanë vënë re që diskursi radikalist gjen hapësirë shpesh në mbulimin mediatik. Në këtë rast ekziston mundësi e steriotipizimit të komuniteteve të ndryshme lokale apo besimtarëve të një feje të caktuar.

Në mediat kryesore mund të evidentohet lehtësisht mungesa e gazetarëve të specializuar për të raportuar mbi çështjet fetare.[2] Krahas mungesës së gazetarëve të specializuar, prezenca në rritje e lajmeve të rreme, presionet mbi gazetarët për lajmin e minutës së fundit, kanë bërë që raportimi mbi ekstremizmin apo terrrorizmin të jetë një sfidë e vazhdueshme për median shqiptare.

Nevoja për të përmirësuar aftësitë profesionale në këtë drejtim pranohet edhe nga vetë komuniteti i gazetarëve. Rezultatet e anketës të realizuar tregojnë se vetë gazetarët janë të mendimit nuk i kanë aftësitë e nevojshme për të raportuar ngjarje të tilla. Të pyetur nëse mendojnë që i kanë aftësitë e nevojshme për të raportuart ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, 78% e tyre janë shprehur se aftësitë e tyre kanë nëvojë të pëmirësohen. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të treguar shkallën e njohjes së problematikës nga vetë komuniteti i gazetarëve dhe redaktorëve të medias. Gjithashtu kjo e dhënë mbështet edhe interesin e lartë që kanë të intervistuarit për pjesëmarrjen në trajnime.

Figurë 3- Aftësia për të raportuar

Mungesa e aftësive të nevojshme të gazetarëve për raportimin e ekstremizmit, vjen si rezultat i mosnjohjes së koncepteve gjatë formimit universitar dhe mospjesëmarrjes në kurse trajnimi. Shumica e gazetarëve nuk kanë marrë pjesë në kurse trajnimi mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Rezultatet e anketës tregojnë se afro 60% e gazetarëve nuk janë trajnuar ndonjëherë për këto tema. Ndërkohë që vetëm 40% ka deklaruar se ka qenë pjesë e trajnimeve. Të dhënat bëhen më domethënëse, nëse shikojmë se cilat janë format e trajnimit. Në shumicën e rasteve gazetarët bëhen pjesë e seminareve aftshkurtra, ndërkohë që shkollat e trajnimit apo kurset afatgjata, janë shumë të rralla.

Figurë 4-Pjesëmarrja e mëparshme në trajnim

Nga ana tjetër vihet re se reporterët e ndjejnë nevojën e manualeve apo udhëzimeve për mbulimin e këtyre ngjarjeve. Praktika e mediave ndërkombëtare, tregon se ekzistenca e këtyre

[2] Rrapo Zgur; "Ekstremizmi fetar në media", Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, 2017

udhëzimeve i ndihmon gazetarët dhe përmirëson cilësinë e raportimit. Gazetarët shqiptarë besojnë në shkallë të lartë se përgatitja e udhëzimeve apo manualeve të posaçme në këtë do të përmirësonte ndjeshëm punën e tyre. Në pyetesor u kërkua nga gazetarët të shprehnin se deri në ç'masë ata mendonin se udhëzimet për pasqyrimin dhe raportimin e ekstremizmit dhe terrorizmit do të përmirësonin raportimin e këtyre temave.

Siç mund të vihet re dhe nga grafiku pjesë më e madhe e të anketuarve kanë bindjen se udhëzimet do ta përmirësojnë raportimin. Rezultatet tregojnë rëndësinë që ka përgatitja e manualeve dhe materialeve të tjera udhëzues për gazetarët. Këto udhëzues jo vetëm që do të lehtësonin punën e reporterëve gjatë mbulimit të këtyre ngjarjeve, por njëkohësisht do të përmirësonin cilësinë e raportimit dhe do të shmangnin shkeljet etike dhe garantonin standardet e nevojshme profesionale. Në këtë pikë është e nevojshme të theksojmë se manualet e botuara nga organizata ndërkombëtare, siç është rasti i UNESCO dhe OSBE-së, nuk janë të mjaftueshëm për të adresuar nevojat e medias shqiptare.



Figurë 5-Udhëzimet lehtësojnë raportimin

Rëndësinë e hartimit të udhëzuesve e pohon edhe redaktorja e Birn Albania, Aleksandra Bogdani e cila është e mendimit se udhëzuesit janë gjithmonë të dobishëm për gazetarët. Ajo ve në dukje kompleksitetin që paraqet mbulimi i këtyre temave dhe efektin që ato kanë mbi opinionin publik. Bogdani shprehet se "Çështjet e ekstremizmit të dhunshëm apo të një fenomeni të pranishëm në Shqipëri siç është radikalizimi, ndërthurin elementë fetarë dhe gjeopolitikë si dhe i tejkalojnë kufijtë e vendeve të caktuara, ndaj është e nevojshme që gazetarët ta njohin këtë kontekst përpara se të intervistojnë njerëz apo të ulen të shkruajnë për çështje të tilla". (Bogdani, 2020)

Ndërsa Sekretari i përgjitshëm i Këshillit Ndërfetar, Genti Kruja shprehet se në krahasim me të kaluarën vihet re një përmirësim i raportimit të medias mbi këto ngjarje. Ai ve në dukje rëndësinë e trajnimit të gazetarëve. "Në krahasim me të kaluarën ka një përmirësim në raportimin e lajmeve të tilla, por gjithsesi vihet re se gazetarët e kësaj fushe nuk janë të trajnuar në përcjelljen e lajmeve delikate, sic është dhe fusha e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Nevojitet një trajnim dhe edukim i gazetarëve që mbulojnë këto çështje dhe ato fetare në bashkëpunim dhe me komunitetet fetare, për të mësuar dhe pikat e dobëta të trajtimit të këtyre çështjeve". (Kruja, 2020)

Raporti me burimet e informacionit

Mbulimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit nga media në Shqipëri, nxjerr në pah dhe marrëdhënien mes gazetarëve dhe burimeve të informacionit, të cilat në shumicën e rasteve kanë qasje të ndryshme përsa i përket bashkëpunimit me median. Në disa raste kjo marrëdhënie nuk i favorizon gazetarët duke e vështirësuar aksesin e tyre tek informacionet e nevojshme për të ndërtuar lajmin. Temat që lidhen me ekstremizmin apo radikalizmin konsiderohen si çështje me ndjeshmëri të lartë për sigurinë kombëtare, argument ky që përdoret shpesh nga institucionet publike për të mos bashkëpunuar me median.

Në rastin e komuniteteve fetare vihet re një mungesë besimi ndaj medias. Komunitetet fetare nga njëra ana ankohen për sensacionalizimin dhe cektësinë e raportimit, ndërkohë që media nga ana tjetër ve në dukje mungesën e transparencës dhe vullnetit për bashkëpunim tek institucionet dhe kleri fetar. Sipas z. Kruja "media troket në dyert e komuniteteve fetare vetëm në raste festash, apo problematikash dhe komunitetet fetare janë të zhgënjyer nga mediat sepse kur ata thirren për lajme pozitive, arritje, evente, konferenca, etj. pyetje që i bëhet është se kush është nga protokolli i shtetit. Vetëm nëse vijnë ata vjen media". (Kruja, 2020)

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor për sa i përket informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror". Ligji i vitit 1999 për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror u amendua në vitin 2006. Ky ligj bën përkufizimet për informacionet që klasifikohen sekrete shtetërore. Për disa vite me radhë, nenet e këtij ligji u bënë pengesë për gazetarët që kërkonin informacione të caktuara nga institucionet shtetërore.

Në vitin 2014 Kuvendi miratoi ligjin nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, i cili rregullon të drejtat e qytetarëve për t'u informuar dhe përcakton afatet konkrete, si dhe procedurat për marrjen e këtij informacioni. Më pas u ngrit edhe institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit si një organ që shqyrton ankesat ndaj institucioneve publike. Gazetarët i kanë shfrytëzuar shpesh hapësirat e këtij ligji për të siguruar informacione nga institucionet publike. Në disa raste institucioni i Komisionerit ka qenë i pamjaftueshëm për të zgjidhur konfliktin e gazetarëve me institucionet publike, duke bërë që këta të fundit t'u drejtohen edhe gjykatave.



Figurë 6-Burimi kryesor i informacionit

Ndonëse kuadri ligjor ekziston, gazetarët shpesh në praktikë përballen me pengesa të shumta. Redaktorja e Birn Albania Aleksandra Bogdani thekson se "kuadri ligjor mundëson një balancë mes ruajtjes së sekretit shtetëror dhe interesit të lartë publik, por në praktikë kjo nuk funksionon". Ajo shprehet se në rastet e mbulimit të ngjarjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm gazetarët hasin vështirësi për të marrë

informacion. “Gazetarët e kanë shumë të vështirë që të sigurojnë informacione që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm apo radikalizmin përmes kërkesave për të drejtë informimi, ndërkohë që institucionet e sigurisë e konsiderojnë “interesin e lartë publik” vetëm për ato raste që u volit atyre”. (Bogdani, 2020)

Rezultatet e anketimit tregojnë se burimi kryesor i informacionit për gazetarët që mbulojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin është policia. Gjatë pyesorit gazetarët u pyetën nëse gjatë vitit të fundit kanë raportuar ngjarje të kësaj natyre dhe nëse po, cili ka qenë burimi kryesor i informacionit.

Nga rezultatet e kësaj pyetjeje vihet re se më shumë se gjysma e gazetarëve deklarojnë si burim kryesor policinë e shtetit, ndërsa në vend të dytë është Ministria e Brendshme dhe më pas vijnë komunitetet fetare.

Vlerësimi i bashkëpunimit me secilin nga burimet e përmendura, ishtë një tjetër komponent i pyetësorit. Rezultatet tregojnë se gazetarët e vlerësojnë mesatarisht shkallën e bashkëpunimit me institucionet publike dhe komunitetet fetare. Megjithatë vlen të përmendet se Ministria e Brendshme vlerësohet si më pak bashkëpunuese nga gazetarët. Vlerësim jo shumë të mirë kanë marrë dhe organizatat e shoqërisë civile që renditen të dytat për nga numri i gazetarëve të cilet e konsiderojnë të dobët bashkëpunimin, ndërkohë që më pas renditen gjykatat dhe komunitetet fetare. Policia e shtetit krahas faktit që shërben si burim kryesor i informacionit për median, është dhe institucioni më i vlerësuar. Nga të dhënat e anketës, policia ka numrin më të ulët të vlerësimeve “dobët”.



Figurë 7-Vlerësimi për bashkëpunimin

Shqetësimet në lidhje me raportimin e ekstremizmit

Mbulimi i ekstremizmit të dhunshëm nga media dhe puna e gazetarëve që raportojnë për këto ngjarje përballet shpesh me sfida dhe pengesa të shumta. Në këndvështrimin e gazetarëve këto pengesa konsiderohen si shqetësime që duhen adresuar në mënyrë që të rritet cilësia e mbulimit mediatik. Transparenca e institucioneve shtetërore, gjuha e urrejtjes, dezinformimi dhe lajmet e rreme, mungesa e njohjes së terminologjisë së fushës dhe asaj fetare, janë disa nga shqetësimet më të shumta që sjellin në vëmendje gazetarët.

Gazetarëve të anketuar iu kërkua që të shprehnin vlerësimin e tyre për secilin nga elementët e paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Këto elementë u përfshinë në pyetësor pas një analize të detajuar të studimeve dhe raporteve të shumta të publikuara më parë. Qëllimi në këtë rast ishte evidentimi i elementëve më shqetësues, të cilët pengojnë ose vështirësojnë punën e medias për

mbulimin e ngjarjeve që lidhen me ekstremizin e dhunshëm, terrorizmin apo radikalizmin. Këto të dhëna vlejnë edhe për të ndërtuar një qasje më konkrete në raport me nevojat e gazetarëve që mbulojnë këto ngjarje.

Tabela 1-Shqetësimet në lidhje me raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Vlerësoni nga 1 (jo-problematik) në 7 (jashtëzakonisht problematik) shqetësimet e mëposhtme në lidhje me raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.								
	1 (jo-problematik	2	3	4	5	6	7 (jashtëzakonisht problematik)	Grand Total
Sensacionalizmi		2	12	15	11	2	4	46
Niveli i ulët i njohurive për edukimin mediatik		4	7	8	11	3	13	46
Gjuha e urrejtjes	1	5	9	7	6	3	14	45
Islamofobia	4	4	9	7	8	6	8	46
Dezinformimi		0	6	8	10	7	15	46
Mungesa e njohjes së terminologjisë të temës nga gazetarët	1	3	5	5	13	7	11	45
Mungesa e njohjes së terminologjisë fetare nga gazetarët		3	8	2	8	14	10	45
Transparenca e institucioneve shtetërore	2	1	2	9	5	9	18	46
Informacioni i klasifikuar	1	2	10	6	10	8	9	46
Konspiracionet	4	7	9	5	3	7	11	46

Nga të dhënat e tabelës mund të vemë re se një nga shqetësimet kryesore për njerëzit e medias është transparenca e institucioneve shtetërore.



Figurë 8-Transparenca e institucioneve shtetërore

Numri i gazetarëve që e kanë vlerësuar si "jashtëzakonisht problematik" dhe atyre që mendojnë se *transparenca* është shumë problematike, të marra së bashku përbëjnë afro 60% e të gjithë numrit të gazetarëve. Perceptimi në këtë rast mund të mos lidhet direkt me eksperiencat e

krijuara nga marrëdhëniet me këto institucione. Megjithatë, duhet theksuar fakti se transparenca ka të bëjë me komunikimin dhe informimin e publikut. Në këtë pikë, gazetarët e pyetur mund të kenë konsideruar problematike qasjen e individëve përgjegjës për transparencën në këto institucione. Nisur nga këto të dhënat del qartë edhe nevoja që ka për trajnimin e specialistëve të komunikimit apo personat që janë të angazhuar si zëdhënës për median, mbi rëndësinë e transparencës dhe marrëdhënien me gazetarët.

Një tjetër shqetësim për gazetarët është fenomeni i lajmeve te rreme dhe ndikimi që ato kanë mbi raportimin mediatik. Pas transparencës se institucioneve shtetërore, *dezinformimi* është shqetësimi i dytë më i madh për gazetarët e anketuar. Rezultatet e kësaj pyetjeje është e nevojshme të shikohen të kombinuar me pyetjen që vlerëson perceptimin e gazetarëve mbi njohuritë e tyre rreth këtyre temave si dhe me shkallën e pjesëmarrjes në trajnime.

Nëse i referohemi rezultateve të pyetjes që interesohet për pjesëmarrjen ose jo të gazetarëve në trajnime për lajmet e rreme dhe dezinformimin, vemë re se 76% e të anketuarve deklarojnë se kanë marrë pjesë. Ndërkohë që përsa i përket pyetjes që mat perceptimin mbi njohuritë që kanë gazetarët për lajmet e rreme dhe dezinformimin rezultatet tregojnë një panoramë më pozitive sesa për njohuritë rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

Vetëm 2% e gazetarëve i kanë vlerësuar njohuritë e tyre mbi këto fenomene si të dobëta. Megjithatë ndonëse pjesëmarrja në edukim të vazhdueshm nëpërmjet trajnimeve është e lartë dhe vlerësimi i njohurive është pozitiv, dezinformimi mbetet një shqetësim real për gazetarët, në raportimin e ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe radikalizmit.



Figurë 9-Niveli i njohurisë mbi lajmet e rreme dhe dezinformimin

Një nga arsyet kryesore për këtë, lidhet me faktin se vetë organizatat ekstremiste i përdorin lajmet e rreme si taktikë e propagandës së tyre. Sa më shumë njohuri që gazetarët të kenë mbi dezinformimin dhe përdorimin e lajmeve të rreme nga grupet ekstremiste, aq më të mbrojtur do jenë në punën e tyre. Ndër shqetësimet e tjera kryesore janë renditur, *gjuha e urrejtjes, niveli i ulët i njohurive për edukimin mediatik, mungesa e njohjes së terminologjisë të temës nga gazetarët, dhe konspiracionet*.

Studentët e gazetarisë

Mbulimi i ekstremizmit dhe radikalizmit si pjesë e kurrikulës universitare

Diskutimi mbi temat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit është prezent në auditorët e shkollave të gazetarisë dhe komunikimit në vend. Megjithatë duket se nuk i kushtohet një vëmendje e veçantë edukimit të brezit të ri të gazetarëve për të mënyrën e raportimit të këtyre

temave. Anketa e zhvilluar me studentët e programeve të gazetarisë dhe komunikimit, ka si synim evidentimin e nevojave gazetarëve të ardhshëm në këtë drejtim.

Përfshirja e temave që do rrisnin shkallën e njohurisë së studentëve mbi konceptet e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, apo radikalizmit në kurrikulën e programeve të studimit, do t'i ndihmonte ata të kuptojnë më mirë zhvillimet në këtë fushë.



Figurë 10-Përfshirja në kurrikul

Njohja e koncepteve teorike dhe dallimi i përkufizimeve për secilin nga fenomenet e mësipërme, do të shmangte gabimet dhe keqkuptimet gjatë raportimit të ngjarjeve. Studentëve iu kërkua të shprehnin shkallën e dakordësisë për përfshirjen në kurrikulën e programeve në të cilat ata studiojnë, të kurseve mbi raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Rezultatet tregojnë që më shumë se gjysma studentëve mbështetin idenë e përfshirjes së këtyre kurseve në kurrikul.

Është e nevojshme që përfshirja e këtyre temave në lëndë të ndryshme që kanë të bëjnë më shkrimin dhe raportimin e lajmeve, apo në formë të moduleve të veçanta të marrë parasysh si aspektin e formimit teorik ashtu edhe analizën e rasteve studimore. Duke u nisur nga ideja se shpesh raportimi mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin lidhet me fenë, është e nevojshme që njohuritë e studentëve të gazetarisë të zgjerohen edhe në drejtim të njohjes së feve, si nga pikëpamja historike, ashtu edhe nga marrëdhënia që ato kanë me njëra tjetrën.

Lektori i departamentit të komunikimit dhe gazetarisë në Universitetin e Tiranës, Ramadan Çipuri e shikon çështjen pëtej edukimit në nivel universitar. "Çështja shtrohet përtej përfshirjes së këtyre temave në kurrikulën e departamentit të gazetarisë. Është e nevojshme që njohuritë të ofrohen në nivele të ndryshme të arsimit. Në arsimin parauniversitar duhet te përfshihen çështje që kanë të bëjnë me kulturen fetare. Këtu nuk bëhet fjalë për mësime fetare, por për njohuri bazike rreth besimeve të ndryshme fetare, për festat e tyre, për elementet me ndjeshmëri të lartë, cënimi i të cilëve mund të nxisë konflikte të ndryshme". (Cipuri, 2020)

Shkalla e njohurisë te studentët



Figurë 11-Shkalla e njohurisë te studentët

Njohuria e studentëve mbi konceptet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit duket se është në nivel të ulët. Të dhënat e sondazhit tregojnë se një e katërta e studentëve i vlerësojnë njohuritë e tyre rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe terrozimit si shumë të dobëta. Ndërsa

40% e tyre shprehen se njohuritë e tyre janë mesatare. Me fjalë të tjera 65% e studentëve të gazetarisë dhe komunikimit në vend kanë njohuri jo të mjaftueshme rreth terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ky nivel i njohurive është një tregues i rëndësishëm për të kuptuar nevojën që ka ky kontigjent i profesionistëve të ardhshëm të medias, për të mësuar më shumë rreth koncepteve teorike dhe qasjeve praktike të mbulimit mediatik për terrorizmin dhe ekstemizmin e dhunshëm. Nga ana tjetër këto të dhëna janë në një kontrast të dukshëm përsa i përket vlerësimit të studentëve për njohuritë e pedagogëve të tyre.

Studentët u pyetën sesi ata i vlerësonin njohuritë e profesorëve të tyre mbi të njëjtat tema dhe përgjigjet tregojnë një vlerësim mjaft të lartë. Më konkretisht, 65% e të anketuarve në këtë kategori, i vlerësojnë njohuritë e stafit akademik të këtyre departamenteve, mbi terrozimin dhe ekstremizmin e dhunshëm si shumë të mira ose të shkëlqyera.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që vlen të analizohet është edhe perceptimi i studentëve të gazetarisë mbi çështjet që duhen përmirësuar në mënyrë që të kemi një mbulim më të mirë mediatik të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Studentëve të aketuar iu kërkua të shënonin se në cilat fusha duhet të ndërhyhet për të përmirësuar mbulimin dhe raportimin e ekstremizmit. Rezultatet tregojnë se fokusi i studentëve është i përqëndruar në katër fusha. Ata mendojnë se *etika në media, kurrikula e shkollës së gazetarisë, njohuria e gazetarëve* rreth temës dhe *pavarësia e gazetarëve*, janë fushat ku duhet të ndërhyhet. Analiza për këtë pyetje është bazuar në frekuencën sesa herë është përmendur secila nga fushat që duhen përmirësuar, nga baza e të anketuarve. Të dhënat tregojnë se studentët e njohin nevojën e përmirësimit të kurrikulës së gazetarisë në këtë drejtim. Kjo fushë qëndron e dyta për nga frekuenca. Ky rezultat na ndihmon të kuptojmë se kurrikulat e programeve të gazetarisë në universitet shqiptare, kanë nevojë të reformohen duke u orientuar drejt pajisjes së studentëve me kapacitete dhe aftësi praktike.



Figurë 12-Fushat që duhen përmirësuar

Ndërkohë një tjetër e dhënë e rëndësishme nga ky grafik, mund të konsiderohet perceptimi i studentëve mbi respektimin e normave etike në median shqiptare. Rezultatet tregojnë se studentët e gazetarisë e shikojnë *respektimin e etikës në media* si një fushë prioritare për tu përmirësuar. Respektimi i normave etike në media, mbetet ende një sfidë për median shqiptare. Në këtë rast mund të konsiderohet pozitiv fakti që gazetarët e së ardhmes janë të ndërgjegjësuar, për rëndësinë që ka respektimi i etikës në media.

Gjuha e urrejtjes

Ndërkohë përsa i përket shqetësimeve, studentët kanë vlerësuar se *gjuha e urrejtjes në media* është çështje që dëmton raportimin mediatik të ekstremizmit dhe terrorizmit. *Gjuha e urrejtjes* vlerësohet jashtëzakonisht problematike nga 55% e të anketuarve.



Figurë 13-Gjuha e urrejtjes

Në ditët e sotme, përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga ana e mediave është një temë e debatueshme në shumë vende të ndryshme. Gazetarët dhe mediat e shikojnë fenomenin nga këndvështrimi i burimit të gjuhës së urrejtjes.

Ky këndvështrim vendos në qëndër të akuzës si burim i gjuhës së urrejtjes, politikën dhe diskursin publik të politikanëve. Në kontekstin shqiptar duket se kjo qasje gjen vend më tepër duke patur parasysh, diskursin publik të politikanëve, të cilët në mjaft raste i tejkalojnë çdo normë etike të komunikimit publik, duke përfshirë në ligjëratat e tyre, elementë të urrejtjes, gjuhë diskriminuese apo edhe fyerje nga më të rëndomtat. Pra gjuha e urrejtjes që ne hasim në media, sipas këndvështrimit të gazetarëve, vjen si një zgjedhje e detyruar, për shkak të pasqyrimit që mediat i bëjnë aktualitetit dhe zhvillimeve në vend. Në pamje të parë kjo perspektivë duket se krijon një korrnizë justifikuese për vetë profesionistët e medias, të cilët e delegojnë përgjegjësinë te burimi i cituar në lajm.

Një monitorim me titull "Prirjet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare" i kryer nga Instituti shqiptar i medias dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur, ka evidentuar si tipar karakterizues të shtypit shqiptar, sensacionin në titujt e lajmeve të kronikës. (Instituti Shqiptar i Medias, 2015)

Ndërkohë që sipas të njëjtit monitorim vihet theksi në gjuhën e sjellë në ekran apo në faqet e gazetave, nëpërmjet intervistimit të të afërmve të viktimave apo personave të përfshirë në ngjarje kriminale. Për nga vetë konteksti në të cilën ndodhen personat e inervistuar, është e natyrshme që në gjuhën e përdorur nga ata, të këtë dozë të fortë emocioni, ndjenjë hakmarrjeje dhe gjuhë urrejtje. Në këtë rast, reporteri vihet përpara dilemës etike nëse duhet ta përfshijë në lajm, një gjuhë të tillë apo duhet të përdorë perifrazmin dhe të përcjellë citimin me fjali të përgjithshme.

Shoqëria civile

Shoqëria civile konsiderohet si një nga aktorët më të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Studime të ndryshme kanë përcaktuar se roli i organizatave të

shoqërisë civile është veçanërisht i rëndësishëm në identifikimin dhe trajtimin e pakënaqësive të individëve apo grupeve të caktuara, me potencial të lartë për t'u ekstremizuar apo radikalizuar.

Një udhëzues për Europën Juglindore i përgatitur nga OSBE për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, ka renditur disa arsye pse shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Sipas këtij dokumenti shoqëria civile ka kapacitete dhe përvojë të nevojshme, si dhe njohurinë për dinamikat lokale të shoqërisë. Nga ana tjetër organizatat që disponojnë ekspertizën e duhur mund të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përfaqësuesve, "të medias, të rinjve, komuniteteve fetare, nëpunësve civilë apo aktorëve të sistemit të drejtësisë, lidhur me një spektër të gjerë dhe shumëplanësh të adresimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm." (Ngjela & Vuksani, 2018)

Pyetësori i përgatitur për përfaqësuesit e shoqërisë civile, synon të vlerësojë njohuritë mbi terrorizmin, eskstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, shkallën e bashkëpunimit dhe perceptimin mbi shqetësimet kryesore në lidhje me raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Bashkëpunimi i aktorëve të ndryshëm në kuadër të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, konsiderohet si mjaft i domosdoshem.



Figurë 14-Hartimi i Udhëzimeve

Në këtë studim, jemi përpjekur të kuptojmë shkallën e bashkëpunimit mes medias, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë. Në këtë drejtim, një nga pyetjet që iu drejtua përfaqësuesve të shoqërisë civile, ka të bëjë me rolin që luajnë udhëzuesit në përmirësimin e bëshkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm. Rezultatet e pyetjes përkatëse tregojnë se një shumicë mjaft e konsiderueshme e të anketuarve janë të mendimit se hartimi i udhëzimeve për ekstremizmin e dhunshëm do të përmirësojë bashkëpunimin mes medias, shoqërisë civile, komuniteteve fetare dhe aktorëve të tjerë.

Kyetari i Qendrës për Bashkëpunim Ndërfetar, Arben Ramkaj e shikon bashkëpunimin mes aktorëve si shumë të nevojshëm, ndërkohë që e ve theksin te nevoja për më shumë ekspertë në fushën e ekstremizmit të dhunshëm me sfond fetar.

Ai vëren se një pjesë e mirë e organizatave të shoqërisë civile të përfshira në projekte që synojnë adresimin e këtyre çështjeve kanë pak eksperiencë. "Mendoj se shumë aktorë që janë përfshirë në këtë fushë janë të rinj në fushën e ekstremizmit të dhunshëm pasi edhe çështja është e re për realitetin shqiptar. Krahas faktit që është e re, ekstremizmi i dhunshëm me karakter fetar, ka një specifikë të veçantë. Kjo fushë kërkon ekspertë dhe dije. Shumica e aktorëve që zhvillojnë

projekte të donatorëve të ndryshëm në këtë fushë, kanë qenë të papërgatitur. Megjithatë mendoj se projekte të tilla kanë patur efekt në adresimin e çështjes. Studimet e kryera më parë nga organizata të shoqërisë civile kanë krijuar një shtrat të mirë për të kuptuar gjendjen e ekstremizmit të dhunshëm". (Ramkaj, 2020)

Në krahasim me grupet e tjera të intervistuara, duket se përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë një nivel relativisht më të lartë të njohurive mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.



Figurë 15-Shkalla e njohurisë së shoqërisë civile mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

Niveli i njohurive është matur përmes dy pyetjeve të veçanta. Në pyetjen e parë të anketuarit janë vlerësuar për njohurinë rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, ndërkohë që në një pyetje të dytë, është kërkuar niveli i njohurive rreth Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit.

Të dhënat na tregojnë se përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë njohuri mbi këto tema. Vetëm 3% e të anketuarve i ka vlerësuar njohuritë si të dobëta, ndërkohë që 70% e tyre i i vlerëson njohuritë si "të mira" dhe "shumë të mira".

Arsyet për këtë rezultat mund të lidhen me faktin se organizata të shoqërisë civile janë përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe kanë qenë shpesh pjesë e tryezave të diskutimit të organizuara për këto çështje.

Strategjia kombëtare është dokumenti bazë që shërben për orientimin e politikave dhe rolin e aktorëve të përfshirë në parandimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo është arsye që në pyetesor është përfshirë pyetja për të kuptuar se deri në çfarë arrin njohuria e profesionistëve të përfshirë në organizatat e ndryshme. Të dhënat e kësaj pyetjeje tregojnë se 40% e të pyeturve deklarojnë se kanë njohuri të mira rreth Strategjisë ndërkohë që 23% e njeh Strategjinë, por nuk njeh masat në kuadër të Planit të Veprimit.

Nevojat për trajnim sipas këndvështrimit të shoqërisë civile

Në mesin e përfaqësuesve të shoqërisë civile ekziston një bindje e plotë se ka nevojë për më shumë trajnim dhe rritje të njohurive si për gazetarët që mbulojnë këto çështje ashtu edhe për zëdhënësit e institucioneve publike, të cilët shpesh shërbejnë si burim informacioni për median.



Figurë 16-Nevoja për trajnim

Më konkretisht, 77% e të anketuarve mendojne se ka shumë nevojë për trajnimin e gazetarëve, ndërkohë që 73% mendojnë në të njëjtën mënyrë përsa i përket trajnimit të zdhënësve dhe specialistëve të komunikimit të institucioneve shtetërore.

Rezultatet na japin një këndvështrim të ri përsa i përket nevojës për të rritur njohuritë dhe aftësitë e reporterëve dhe zëdhënesve të institucioneve publike. Në këndvështrimin e profesionistëve nga shoqëria civile, rritja e aftësive dhe kacapiteteve të medias mbetet një nevojë evidente. Të dhënat janë në përputhje me vlerësimin që vetë gazetarët kanë bërë përsa i përket nevojës për trajnim. Nëse i referohemi të dhënave të dala nga anketa me gazetarët, do të vemë re se 78% e tyre mendojnë se aftësitë e tyre për raportimin e ekstremizmit nuk janë të mjaftueshme dhe duhen përmirësuar.

Bashkëpunimi i shoqërisë civile me aktorë të tjerë



Figurë 17-Bashkëpunimi me Median

Vlerësimi i shoqërisë civile në lidhje me nivelin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në kuadër të luftës kundër eskremizmit dhe terrorizmit, është një nga treguesit e rëndësishëm të këtij studimit. Bazuar në rezultatet e anketës vihet re se shoqëria civile ka vlerësim mesatar përsa i përket bashkëpunimit me median tradicionale. Më shumë se 50% e të anketuarve vlerëson se bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe medias tradicionale është i mirë, ndërsa 13% mendojnë se ky bashkëpunim është i dobët. Vlerësimi i bashkëpunimit mes medias dhe shoqërisë civile, perceptohet ndryshe nga secili prej këtyre dy grupeve. Ndërkohë që gazetarët mendojnë se bashkëpunimi është i dobët me shoqërine civile, kjo e fundit, siç mund të vihet re dhe në grafik ka një vlerësim disi me pozitiv.

Bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe medias ka një rëndësi të veçantë duke patur parasysh faktin se një sërë organizatash janë të angazhuara në projekte të ndryshme në fushën e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Këto organizata, janë të fokusuara në studimin e arsyeve që çojnë në radikalizimin dhe ekstremizmin e individëve apo komuniteteve të caktuara në vend. Hulumtimet e bëra në terren dhe të dhënat e nxjerra nga studime të kryera nga organizata të shoqërisë civile, mund të

shërbejnë si burim parësor informacioni për median, në mënyrë që raportimi mbi këto ngjarje të jetë sa më i plotë dhe professional. Nga ana tjetër shoqëria civile duhet të forcojë bashkëpunimin me median, në mënyrë që puna e tyre me komunitetet dhe gjetjet e studimeve, t'i përcillen sa më mirë publikut dhe aktorëve të tjerë të përfshirë.

Pengesat sipas shoqërisë civile

Gjuha e urrejtjes, niveli i ulët nohjes së terminologjisë, transparenca e institucioneve shtetërore dhe dezinformimi, janë disa nga shqetësimet kryesore që shoqëria civile evidenton si pengesa për raportimin ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Kompionit të anketimit nga shoqëria civile iu drejtua e njëjta pyetje si në rastin e gazetarëve. Qëllimi ishte të evidentohej nga këndvështrim i aktorëve jashtë medias, se cilat janë shqetësimet dhe pengesat kryesore për raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Ballafaqimi i dy këndvështrimeve na ndhimon të krijojmë një ide me qartë mbi pengesat dhe vështirësitë e raportimit të terrorizmit dhe ekstremizmi të dhunshëm.

Rezultatet nga anketës me përfaqëuesit e shoqërisë civile kanë konfimuar pothuajse të njëjtën listë me shqetësime që doli nga rezultati i anketës me gazetarët dhe redaktorët e medias. Më konkretisht në rastin e gazetarëve shqetësimi kryesor ishte transparenca e institucioneve shtetërore ndërsa për përfaqësuesit e shoqërisë civile, shqetësimi më i madh qëndron te njohja e terminologjisë për ekstremizmin e dhunshëm nga gazetarët. Dezinformimi dhe lajmet e rreme mbeten një pengesë serioze edhe në vlerësimin e shoqërisë civile. Vëmendja që ka marrë fenomeni i lajmeve të rreme dhe angazhimi i madh për adresimin e këtij problemi jo vetëm si një çështje e medias, por edhe si një problem për mbarëvajtjen e demokracisë, ka bërë që edhe organizatat e shoqërisë civile ta shikojnë si një shqetësim madhor. Islamofobia, ashtu në rastin e gazetarëve, edhe për shoqërinë civile perceptohet jo si shqetësim për raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.



Figurë 18-Mungesa e njohjes së terminologjisë sipas Shoqërisë Civile

Zëdhënësit e institucioneve shtetërore

Zëdhënësit dhe specialistët e komunikimit në agjencitë dhe institucionet shtetërore luajnë një rol të rëndësishën në përhapjen e informacionit mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Marrëdhënia që ata ndërtojnë me gazetarët dhe median ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mbulimin

dhe raportimin e këtyre ngjarjeve. Kjo marrëdhënie shpesh përballet me sfida dhe vështirësi, që dalin më shumë në sipërfaqe si rezultat i shkallës së lartë polarizimit të skenës mediatike. Një tjetër faktor që ndikon në këtë marrëdhënie është profesionalizmi i personave që janë të angazhuar në strukturat e komunikimit pranë institucioneve publike.

Informacioni në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm apo terrorizmin, në këndvështrimin e institucioneve publike paraqet ndjeshmëri të lartë publike. Kjo bën që shpesh personat përgjegjës për të përcjelle këtë informacion të media, të kenë një qasje jo shumë bashkëpunuese. Në një farë mënyre, organizmat shtetëore përpiqen ta monopolizojnë këtë informacion dhe ta klasifikojnë atë si sekret, duke mos treguar vullnet të mjaftueshëm për të rritur shkallën e transparencës ndaj medias dhe publikut.

Në vija të përgjithshme mund të thuhet se informacioni për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin shpesh çonë drejt një marrëdhënie jo shumë bashkëpunuese mes medias dhe institucioneve publike. Rezultatet e këtij studimi e konfirmojnë mungesën e besimit që ekziston mes gazetarëve dhe specialistëve të komunikimit në agjencitë shtetërore.

Bashkëpunimi me median online duket se është më i vështirë, në përceptimin e zëdhënësve dhe profesionistëve të komunikimit. Më shumë se një e treta e të anketuarve në këtë kategori e ka vlerësuar bashkëpunimin me mediat online si të dobët. Në raport me mediat e tjera, vlerësimi për portalet informative online është në nivelin më të ulët. Në rastin e mediave tradicionale shifra e atyre që e konsideron bashkepunimin "të dobët" mbetet në nivelin 12%. Ndërkohë 19% e të anketuarve e konsiderojnë si mesatar bashkëpunimin me median online. Rezultati në fakt konfirmon shqetësime tashmë të njohura përsa i përket mënyrës sesi funksionojnë portalet informative online në vendin tonë.



Figurë 2-Bashkëpunimi i Zëdhënësve me Median online

Megjithëse mungojnë të dhëna të konfirmuara, Shqipëria ka një numër të madh portalesh informative. Studime të ndryshme që i referohen deklaratave të Unionit të Gazetarëve dhe të dhënave të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), japin shifra të ndryshme për numrin e portaleve të lajmeve. Një studim i kryer nga IDRA media që i referohet të dhënave të vitit 2016 të AKEP, evidenton 650 portale lajmesh. (ZAJMI & PETRAK, 2019). Ndërkohë deklaratat e Unionit të Gazetarëve, e çojnë numrin e portaleve në 800. (Cela, 2019).

Debati për nevojën e rregullimit të tregut vazhdon prej kohësh mes qeverisë dhe komunitetit të medias. Pavarësisht mënyrës sesi palët argumentojnë qëndrimet e tyre, duket se nevoja për të krijuar disa standarde në gazetarinë online, është evidente. Së pari është e nevojshme krijimi i një

formati regjistrimi për portalet online, në mënyrë që të eleminohet shkelja e standardeve profesionale për shkak të anonimatit.

Një studim i Institutit sSqiptar të Medias, ka zbuluar se afro 40% e portaleve të lajmeve janë të regjistruara si biznese më vete, 23% e mediave online, funksionojnë si pjesë e biznesit të medias tradicionale, ndërsa 12% janë të paregjistruara (ISHM, 2018). Duke marrë parasysh faktin që ky treg është shumë dinamik, përqindja e portaleve të paregjistruara mund të jetë edhe më e lartë.

Së dyti, është e nevojshme që redaksitë e mediave online të krijojnë krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet publike. Një zëdhënës i medias në një institucion publik e ka të nevojshme të ndërtojë marrëdhënie me redaktorin apo drejtuesin e redaksisë në një portal lajmesh online. Në disa raste ky kontakt mund të mos jetë aq i lehtë, për vetë problematikat që u përmendën më lart. Problemi duhet parë edhe nga ana e personave përgjegjës për informacionin në agjensitë shtetërore. Me rëndësi mbetet rritja e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme mbi marrëdhëniet me median dhe transparencën me publikun.

Rritja e aftësive profesionale

Aftësitë profesionale dhe njohuritë e profesionistëve të komunikimit në institucionet publike, ndikojnë drejtpërsëdrejti në perceptimin e medias dhe publikut në lidhje me transparencën e këtyre institucioneve. Në pjesën më të madhe personat e angazhuar si zëdhënës, këshilltarë për median, apo specialistë komunikimit vijnë nga sektori i medias. Megjithatë pozicioni i tyre si pjesë e kabineteve të titullarëve, u jep një profil të pastër politik në syrin e gazetarëve dhe publikut. Për rrjedhojë ata shpesh perceptohen si persona të politizuar që lenë mënjanë anën profesionale. Pjesëmarrja në programe trajnimi dhe nxitja e vazhdueshme e bashkëpunimit me median si një nevojë dhe detyrim për të garantuar transparencën e institucioneve, përbën një nga alternativat kryesore të zgjidhjes së problematikës. Për të adresuar si duhet këtë situatë, fillimisht është e nevojshme të kuptohet perceptimi i vetë personave që mbajnë këto detyra. Të dhënat e grafikut të mësipërm na ofrojnë një panoramë të qartë të vetëvlerësimit të aftësive profesionale. Të anketuarve ju kërkua të vlerësonin sesa shpesh ata vërenin se ju mungojnë aftësitë e duhura për të dhënë informacion mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizimin.

Figurë 20-Mungesa e aftësive për të raportuar mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

Të dhënat tregojnë se 56% përqind e të anketuarve vërejnë se ju mungojnë aftësitë në këtë drejtim "relativisht shpesh dhe "disi shpesh". Ndërkohë që vetëm 13% pranojnë se nuk ju mungojnë asnjëherë aftësitë për të raportuar rreth terrozimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Këto të dhëna vërtetojnë nevojën për të rritur aftësitë profesionale të personave që janë përgjegjës për informacionin dhe komunikimin në institucionet publike. Rritja e aftësive profesionale do të ndikojë edhe në marrëdhënien e tyre me gazetarët dhe median. Interesi për të marrë pjesë në trajnime është i lartë. Më shumë se gjysma e pyeturve, janë shprehur interes të lartë për të marrë pjesë në trajnime për raportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizimit.

Ky nivel i interesit për trajnim është një tregues i rëndësishëm për të kuptuar sesa nevojë ka për përmirësimin e komunikimit me median dhe publikun në institucionet publike në përgjithësi dhe në veçanti ato të cilat disponojnë informacione rreth ekstremizmit të dhunshëm. Nga ana tjetër interesi për t'u trajnuar tregon dhe gadishmërinë e personave përgjegjës për komunikimin për të rritur aftësitë e tyre profesionale. Në perceptimin e kësaj kategorie, shqetësimet kryesore që renditen si pengesë për mbulimin dhe raportimin mediatik të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, mbeten pothuajse të njëjta me atë të gazetarëve, studentëve të gazetarisë dhe shoqërisë civile. Ndër shqetësimet kryesore mbetet *dezinformimi, lajmet e rreme dhe gjuha e urrjetjes.*

Figurë 21-Interesi per trajnim

PËRFUNDIME

Ekologjia e sotme e mediave dallon thelbësisht nga ajo e dy dekadave më parë. Monopoli i mediave konvencionale në hapësirën informative nuk ekziston dhe gazetari i ditëve të sotme është i destinuar të bashkëpunojë me audiencat në procesin e prodhimit të informacionit. Jetojmë në një kohë kur informacioni është produkti me jetëshkurtër që ekziston në treg dhe ku ritmi i komunikimit është marramendës. Në këtë hapsirë ku audienca është bërë pjesë e procesit të prodhimit të informacionit, sfida më e madhe për gazetarët e mediave konvencionale dhe mediave online, mbetet besueshmëria, respektimi i etikës dhe profesionalizmi.

Ekstremizmi i dhunshëm, terrorizmi dhe radikalizmi janë fenomene që po venë në provë normat profesionale dhe etike të gazetarëve profesionistë. Për të fituar besueshmërinë e audiencave, gazetarët duhet të raportojnë jo vetëm pasojat e ekstremizmit të dhunshëm, por të përpiqen të hulumtojnë rrënjët e problemit. Shpesh raportimi i fakteve është i pamjaftueshëm në gazetarinë e sotme. Krahas raportimit të fakteve gazetarët, kanë detyrë të ofrojnë kontekstin e ngjarjeve duke treguar nivel të lartë njohurie dhe përgjegjshmërie.

Beteja me ekstremizmin e dhunshëm nuk i përket vetëm medias, por gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm së kjo betejë nuk fitohet pa rritur shkallën e profesionalizmit. Studimi për vlerësimin e nevojave të gazetarëve, studentëve të gazetarisë, shoqërisë civile dhe zëdhënësve të intitucioneve publike, tregoi se për t'u përballur me ekstremizmin kërkohet një angazhim i madh në rritjen e kapaciteteve profesionale të aktorëve të përfshirë. Krahas gazetarëve, studentët e shkollave të gazetarisë, shoqëria civile dhe profesionistët e komunikimit në agjensitë shtetërore janë grupet të cilat ishin në fokusin e studimit për vlerësimin e nevojave. Qëllimi i studimi është të njohim dhe kuptojmë në mënyrë specifike situatën, vështirësitë dhe nevojat e secilit nga grupet e lartpërmendura.

Studimi nxorri në pah mungesën e njohurisë së gazetarëve mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe radikalizmit. Krahas mungesës së njohurive mbi ekstremizmin, gazetarët në Shqipëri reflektojnë një shkallë të ulët të njohurive fetare, çka e vështirëson së tepërmi raportimin, veçanërisht kur kërkohet mbulimi i ngjarjeve që lidhen me ekstremizmin fetar.

Gazetarët e mediave tradicionale dhe atyre online, vuajnë nga mungesa e kurseve trajnuese dhe formave të ngjashme të edukimit të vazhdueshëm. Rezultatet e studimit tregojnë se afro 60% e gazetareve në median shqiptare nuk janë trajnuar asnjëherë për këto mbulimin dhe raportimin e këtyre temave. Mungesa e trajnimeve është evidente edhe mes zëdhënësve për shtyp dhe personelin e komunikimit në institucionet publike. Për rrjedhojë gazetarët janë të ndërgjegjshëm për mungesën e aftësive për mbulimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në mesin e gazetarëve ekziston gadishmëria dhe dëshira për t'u bërë pjesë e kurseve trajnuese. Ky tregues vërteton faktin se njerëzit e medias janë të gatshëm të kuptojnë më mirë fenomenin dhe të përmirësojnë njohuritë e tyre.

Një tjetër rezultat i rëndësishëm është evidentimi i mungesës së udhëzimeve etike dhe profesionale për mbulimin mediatik të fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Gazetarët në Shqipëri besojnë se përgatitja e manualeve dhe materialeve të tjera udhëzues për gazetarët është i nevojshëm. Ekziston besim i plotë se udhëzuesit jo vetëm që do të lehtësonin punën e reporterëve gjatë mbulimit të këtyre ngjarjeve, por njëkohësisht do të përmirësonin cilësinë e raportimit dhe do të shmangnin shkeljet etike dhe garantonin standardet e nevojshme profesionale.

Bashkëpunimi mes medias, institucioneve publike, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, mbetet një sfidë e rëndësishme në adresimin e çështjes se ekstremizmit. Rezultatet e këtij studimi

tregojnë se ky bashkëpunim nuk është në nivelin e duhur dhe se mes aktorëve të lartpërmendur ekziston një klimë mosbesimit. Gazetarët kanë vlerësuar burimet e informacionit dhe rezultatet në disa raste tregojnë një shkallë të ulët besimi. Rasti më konkret ishtë perceptimi i gazetarëve për bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme, komunitetet fetare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Analizimi i secilit grup në mënyrë të veçuar dhe më pas ballafaqimi i të dhënave, i shton vlerën studimit. Në pjesën më të madhe rezultatet e dala nga pyetjet e përbashkëta, konfirmojnë gjetjet specifike për secilin nga grupet e marra në analizë.

Studentët e gazetarisë dhe komunikimit, janë profesionistët e ardhshëm të medias. Vlerësimi i mungesave dhe nevojave të këtij grupi, ndihmon në adresimin e shpejtë të tyre. Studimi zbuloi se studentët e gazetarisë, janë po aq të interesuar sa gazetarët profesionistë, për të marrë pjesë në kurse trajnuese për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizimin. Për këtë kategori është e rëndësishme marrja e njohurive mbi fetë, ekstremizmin dhe terrorizmin gjatë viteve të formimit të tyre universitar. Për studentët mbetet e rëndësishme njohja e koncepteve dhe dallimi i përkufizimeve për terrorizmin, ekstremizmin dhe radikalizmin. Kjo do do të shmangte gabimet dhe keqkuptimet gjatë raportimit të ngjarjeve në media.

Studimi analizoi edhe nevojat e zëdhënësve për shtyp në agjensitë dhe institucionet shtetërore. Rezultatet vërtetuan nevojën e trajnimit të këtyre individëve për të rritur shkallën e njohurive fetare dhe njohurive mbi konceptet e terrorizimit dhe ekstremizmit. Më e rëndësishme për këtë kategori mbetet marrëdhënia me median si një nevojë për të rritur transparencën e institucioneve publike para publikut.

BIBLIOGRAFIA

Bogdani, A. (2020, February 10). Raportimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit nga media. (E. Çela, Interviewer)

Cela, E. (2019). *Panoramë e mediave lokale në Shqipëri.* Tirana: Friedrich-Ebert-Stiftung-Instituti Shqiptar i Medias.

Cipuri, R. (2020, February 15). Raportimi i ekstremizmit të dhunshëm në media. (E. Cela, Interviewer)

Dervishi, L. (2018, Shtator 7). Toleranca fetare, ekstremizmi i dhunshëm dhe roli i medias. Tirana.

Hallowell, B. (2016). *MIXED MESSAGES, How the media covers "violent extremism" and what you can do about it.* American Friends Service Committee.

Instituti Shqiptar i Medias, O. (2015). *Prirjet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare. Një monitorim i disa mediave të shkruara dhe online.* Tirane: Instituti Shqiptar i Medias.

ISHM. (2018). *Peizazh i medias online në Shqipëri. Anketë me median online.* Tirana: Instituti Shqiptar i Medias.

Kruja, G. (2020, February 12). Raportimi i ekstremizmit të dhunshëm nga media. (E. Cela, Interviewer)

Marthoz, J.-P. (2017). *Terrorism and the media. A handbook for journalists.* Paris: United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization.

Ngjela, K., & Vuksani, R. (2018). *Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë.* Tirana: Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Ramkaj, A. (2020, February 10). Roli i shoqërisë civie në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. (E. Cela, Interviewer)

Vurmo, G., & Sulstarova, E. (2018). *Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve.* Tirana: Instituti që Demokraci dhe Ndërmjetësim.

ZAJMI, L., & PETRAK, L. (2019). *Panorama e Medias në Shqipëri. Studim mbi profesionistët e medias.* Tirana: Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA).

Zguri, R. (2017). *Ekstremizmi fetar në media.* Tirana: Instituti Shqiptar i medias.